



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-rks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

Field Code Changed

RREGULLORE

MBI MASAT PREVENTIVE DHE PARANDALUESE TË PËRDORIMIT TË DOPINGUT

202~~5~~²

Në përputhje nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës, Kuvendi i BFK-së, në mbledhjen e vet të mbajtur më ~~05.11.2022~~ 26.03.2025 miratoi këtë:

RREGULLORE

MBI MASAT PREVENTIVE DHE PARANDALUESE TË PËRDORIMIT TË DOPINGUT

Neni 1

Me rregulloren e masave për preventivë dhe parandalim të përdorimit të dopingut (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) përcaktohen masat dhe aktivitete për preventivë dhe parandalim të përdorimit të dopingut, si dhe procedurat e masave disiplinore në rastet e përcaktuara të përdorimit të dopingut tek lojtarët.

Neni 2

Dopingu është i ndaluar. Dopingu është një ose më shumë shkelje e rregullave të anti- dopingut. Shkelja e rregullave anti-doping ekziston në rastet e përcaktuara në nenin 50 të ligjit perkates per sport.

Federata e badmintonit e Kosovës është e detyruar të sigurojë, brenda kompetencave të saj që për lojtarët, trajnerët dhe personat tjerë, për të cilët është përcaktuar (krijuar, vërtetuar) përgjegjësi për doping, që të merren masat e duhura, në pajtim me Ligjin për parandalimin e dopingut në sport dhe rregullat e Organizatës përkatëse të Anti-Dopingut, ose rregullat e Agjencisë Botërore Anti-Doping, BWF dhe kësaj rregulloreje.

Neni 3

Të gjithë lojtarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në kryerjen e veprimtarive dhe aktiviteteve sportive brenda BFK-së janë të obliguar të lejojnë dhe mundësojnë kryerjen e kontrollit të dopingut.

Lojtarët që refuzojnë, nuk marrin pjesë, shmangen ose pamundësojnë kontrollin e dopingut, do t'ju shqiptohet masa për shkelje të rregullave anti-doping sikur të ishte pozitiv në testin e dopingut, dhe në rast të përpjekjes së tillë, atij mund ti përcaktohet masa edhe nëse testi i dopingut është negativ.

Neni 4

Lojtari është i detyruar të informojë mjekun i cili është duke e trajtuar atë në lidhje me detyrimin e tij për të mos përdorur substanca dopingut dhe për të siguruar se çdo terapi mjekësore e përdorur nuk përmban substanca dopingut. Nëse terapia e përdorur përmban substanca dopingut, lojtari është i obliguar që të drejtohet Komisionit Anti-Doping të BFK-së me kërkesë për miratimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik.

Në këtë drejtim BFK do të njoftoj lojtarët me të drejtën dhe detyrimin për të kërkuar nga Komisioni Anti-Doping i BFK-së që t'ju liroj ndalesën e përdorimit të substancave të dopingut, në rastin kur ekziston një nevojë e qartë dhe e domosdoshme mjekësore.

Neni 5

Kontrolli i dopingut në Kosovës kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni AntiDoping i BFK-së, kurse në rastet kur kontrolli i dopingut bëhet në garat ndërkombëtare - nën menaxhimin e BWF-së dhe sipas rregullave të tyre.

Kontrolli i dopingut mund të organizohet në garë ose jashtë garës, me paralajmërim dhe pa paralajmërim, dhe kryhet me marrjen e mostrave të urinës dhe të gjakut, ose duke aplikuar teknika të tjera të autorizuar për zbulimin e substancave dhe metodave të ndaluara, ekskluzivisht nga kontrollorët e autorizuar dhe të kualifikuar, ose nga persona që posedojnë leje të lëshuar nga Komisioni Anti-Doping i BFK-së ose nga Komisioni i njohur si ekuivalent

Neni 6

Federata e badmintonit e Kosovës do të përcaktojë me një vendim të veçantë personin përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut në BFK.

Neni 7

Kur në procesin e kontrollit të dopingut krijohet një shkelje e rregullave anti-doping, personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut brenda BFK-së, do të takoj lojtarin me të drejtën që pa vonesë, dhe jo më vonë se 7 ditë, të kërkojë analizën e mostrës "B" me shpenzimet e tij, me të drejtën që të marrë pjesë personalisht ose avokatit në praninë e tij në hapjen dhe analizimin e mostrës "B", me shpenzimet e veta, me të drejtë të kërkojë kopjet e dokumentacionit laboratorik të mostrës "A dhe B", e cila përmban informacionin e kërkuar nga Standardi Ndërkombëtar për analiza laboratorike dhe të drejtë që të jetë në formë të shkruar komentimi mbi rrethanat e rastit aktual (konkret) Komisionin Anti-Doping të BFK-së brenda 7 ditëve. Nëse lojtari nuk e kërkon analizën e mostrës "B" brenda 7 ditëve do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për analizën e mostrës "B".

Nëse me analizën e mostrës "B" vërtetohet analiza e gjetjes së dëshmive e cila largohet prej saj sa është e lejuar ose nëse lojtari shprehimisht apo në mënyrë të heshtur të heqë dorë nga e drejta e analizës së mostrës "B", do të fillojë procesi i marrjes së masave për personat përgjegjës për doping.

Neni 8

Rreth vendosjes së masave të akuzuarit që përballet me shkelje të rregullave anti-doping vendos në shkallë të parë komisioni i disiplinor i BFK-së.

Komisioni Disiplinor do të sigurojë që respekton personalitetin dhe të drejtën e mbrojtjes adekuatë ligjore të personit përgjegjës për doping (respektimi i privatësisë, kërkimi (hulumtimi) me kohë, garantimi i të drejtës për një shpjegim ligjor, gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, të drejtën për një përfaqësues ligjor në shpenzime personale, lejimi i shikimit të dokumenteve, dosjet e dëshmive. pajtueshmëria me standardet në aspektin e dëshmisë së dopingut, informimi me kohë, vendimi dhe me arsyetimi me shkrim në kohë, të drejtën e ankimit, etj).

Ligjshmërinë dhe rregullsinë e procedurës e merr parasysh personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut në BFK.

Neni 9

Masat e shqiptuara për shkelje të rregullave anti-doping janë:

- 1) diskualifikim i rezultateve sportive;
- 2) suspendim i përkohshëm;
- 3) ndalimi për të marrë pjesë në garat

4) — Ndalimi për të kryer funksione në fushën e sportit në periudhë kohore, sipas kushteve dhe në përputhje me ligjin e sportit.

Neni 10

Vendimi i komisionit disiplinor do t'i dorëzohet BWF dhe komisionit Anti-Doping të BFK - së

Neni 11

Nëse BFK-ja nuk vendosë masa për shkelje të rregullave anti-doping brenda një viti prej kur me analizën e mostrave të marra është treguar se lojtari është stimuluar (dopinguar), në shkelje të rregullave anti-doping vendos në shkallë të parë Komisioni Anti-Doping i BFK-së. Komisioni Anti-Doping i BFK- së mundet me pëlqimin e lojtarëve, të vendos mbi shkeljete rregullave anti-doping në shkallë të parë dhe para afatit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 12

Vendimi i komisionit disiplinor mund të atakohet në Komisionin Anti-Doping të BFK-së për afatet dhe për kushtet e parashikuara nga rregulloret mbi përcaktimin e përgjegjësisë të personit që ka kryer shkeljen e rregullave anti-doping, përveç ku në përputhje me ligjin nuk është përcaktuar, d.m.th. nga juridiksioni i BWF për të vendosur lidhur me ankesën.

Neni 13

Nëse në shkeljen e rregullave anti-doping vendos Komisioni Anti-Doping i BFK-së ka të drejtë të caktojë një ekspert i cili do të ndihmojë lojtarët në proces dhe t'ju japë këshilla kur është e nevojshme.

Neni 14

Federata e badmintonit e Kosovës nuk do të njohë një rezultat sporti në arritjen e të cilit ka marrë pjesë lojtari i stimuluar (dopinguar).

Neni 15

Federata e badmintonit e Kosovës nuk do të lejojë pjesëmarrjen në ngjarje sportive një lojtari i cili është dënuar me masë për shkak të dopingut.

Neni 16

Federata e badmintonit e Kosovës është e obliguar që të rregullojë procedurën për njohje ndërsjellë të suspendimit dhe masave të tjera të vendosura nga shoqatat e tjera sportive në vend dhe jashtë vendit dhe për të siguruar që BFK i përmbahet masave të shqiptuara dhe suspendimit.

Neni 17

Federata e badmintonit e Kosovës do të miratojë një program të veprimit antidoping.

Neni 18

Federata e badmintonit e Kosovës është e obliguar për të siguruar përcjelljen e vazhdueshme individuale mjekësore të sportistëve elitari, dhe për këtë qëllim do të nxjerrë aktet e nevojshme dhe për të marrë masa konkrete.

Neni 19

Federata e badmintonit e Kosovës të paktën një herë në vit do të informoj dhe edukoj anëtarët e saj dhe lojtarët me rregulloret aktuale në lidhje me dopingun në sport dhe efektet e dëmshme për shëndetin, kur përdoren substancat e dopingut.

Neni 20

Të gjithë anëtarët e Federatës së badmintonit të Kosovës janë të detyruara të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i masave për të luftuar dopingun në sport.

Neni 21

Federata e badmintonit e Kosovës është e obliguar të shkurtoj pjesërisht ose plotësisht financimin e lojtarit, organizatave sportive dhe subjekteve tjera që nuk përputhen merregullat ekzistuese anti-doping, si dhe nuk kontrollojnë programet anti-doping të anëtarëve të saj dhe zbatimin e këtyre programeve.

Neni 22

Federata e badmintonit e Kosovës do të informojë Ministrinë përgjegjëse për sport dhe me formimin e Agjencisë Anti-Doping mbi masat për të luftuar dopingun të ndërmarra gjatë vitit.

Neni 23

Federata e badmintonit e Kosovës me formimin e Agjencisë Anti-Doping mund t'i propozojë për të kryer kontrollin në garat e caktuara apo kontrollin jashtë garës së ekipeve të caktuara, grupeve të treningut apo lojtarëve individual.

Neni 24

Federata e badmintonit e Kosovës do të njoftoj lojtarët - anëtarët e grupit kombëtar të regjistruar të testimit, me obligimin që Agjencisë Anti-Doping të Kosovës kur të formohet dhe të personit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për të parandaluar dopingun, rregullisht dhe me saktësi ti informojnë në lidhje me vendndodhjen dhe qasjen, përmes formës së ashtuquajtur "whereabout" për lokacionin, në përputhje me rregulloret e dopingut në garat sportive dhe jashtë garës.

Neni 25

Federata e badmintonit e Kosovës rregullisht do të informojë anëtarët e saj dhe lojtarët për listat e referimit të substancave të ndaluara.

Neni 26

Kjo rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj eventual i mëvonshëm do të dorëzohen në Ministrinë përgjegjëse të sportit dhe komisionit anti-doping të BFK-së brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 27

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Prishtinë

~~05/11/2022~~ 26.03.2025

Përfaqësues i autorizuar i BFK-së



|

=====